



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 231, Datë 18.08.2026

MBI

**ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-S LIDHUR ME
KËRKESËN E SHOQËRISË “BUSHTRICA 2017” SH.P.K. PËR LICENCIM NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 59/2026 “Për sektorin e energjisë elektrike”; nenit 14, pika 3, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.08.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 671/6 prot., datë 14.08.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë “BUSHTRICA 2017” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Bushtrica 2”, me kapacitet të instaluar 4,800 kW, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të lumit Bushtricë, në Qarkun e Elbasanit”,

Konstatohet se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 283, datë 06.11.2025, vendosi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “BUSHTRICA 2017” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Bushtrica 2”, me kapacitet të instaluar 4,800 kW, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të lumit Bushtricë, Qarku Elbasan.
- ERE botoi njoftimin për fillimin e procedurës në median e shkruar, në datat 08.11.2025 dhe 10.11.2025, si dhe në faqen zyrtare të internetit dhe në rrjetet sociale. Në përfundim të afatit për paraqitjen e komenteve apo objeksioneve nga të tretët, më datë 09.12.2025, nuk rezultoi të ishin paraqitur të tilla.
- ERE njoftoi Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e procedurës, nëpërmjet shkresës nr. 2726/4 prot., datë 20.11.2025. Nga MIE nuk është paraqitur qëndrim lidhur me këtë procedurë.
- Në vijim të korrespondencës për plotësimin e dokumentacionit, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2726/7 prot., datë 12.12.2025, shoqëria kërkoi pezullimin e përkohshëm të shqyrtimit të aplikimit deri në plotësimin e dokumentacionit, ndaj bordi, me vendimin nr. 341, datë 23.12.2025, vendosi pezullimin e procedurës deri në depozitimin e dokumentacionit të munguar.
- Me shkresën nr. 671/2 prot., datë 29.06.2026, shoqëria depozitoi dokumentacion plotësues dhe kërkoi rinisjen e procedurës.

Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 199, datë 21.07.2026, vendosi heqjen e pezullimit të vendosur me vendimin nr. 341/2025 dhe zgjatjen me 30 (tridhjetë) ditë të afatit të vendimarrjes

- përfundimtare, me qëllim vijimin e komunikimit me shoqërinë, vendim i cili iu komunikua shoqërisë me shkresën nr. 671/4 prot., datë 29.07.2026.
- Shoqëria ka vijuar plotësimin e dokumentacionit, me shkresën nr. 671/5 prot., datë 11.08.2026, por nga shqyrtimi i dokumentacionit të këtij aplikimi rezulton se nevojiten përditësime dhe sqarime lidhur me ecurinë e projektit, konkretisht: *në lidhje me datën për të cilën ka kërkuar shtyrjen e afateve kontraktuale të zhvillimit të projektit; informacion të përditësuar në lidhje me afatin e pritshëm për përfundimin e testeve/komisionimit dhe vënien në punë të impiantit; dokumentacion në lidhje me fillimin e punimeve; dhe raportimet e depozituara në MIE, në zbatim të përcaktimeve kontraktore.*
 - Në referencë të përcaktimeve të nenit 14, pika 3, të Rregullores, me qëllim për të zhvilluar korrespondencën vijuese me shoqërinë dhe depozitimin e informacionit/dokumentacionit përkatës prej saj, vlerësohet se duhet të zgjatet deri në 30 (tridhjetë) ditë afati i vendimmarrjes së bordit të ERE-s në lidhje me kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Bushtrica 2”, me kapacitet të instaluar 4,800 kW, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të lumit Bushtricë, në Qarkun e Elbasanit. Shoqëria “BUSHTRICA 2017” sh.p.k. duhet të depozitojë dokumentacionin e kërkuar brenda 20 (njëzet) ditëve.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së bordit të ERE-s mbi kërkesën e shoqërisë “BUSHTRICA 2017” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Bushtrica 2”, me kapacitet të instaluar 4,800 kW, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të lumit Bushtricë, në Qarkun e Elbasanit.
2. Shoqëria “BUSHTRICA 2017” sh.p.k. të depozitojë, brenda 20 (njëzet) ditëve nga marrja e këtij vendimi, informacionin dhe dokumentacionin lidhur me:
 - a) datën për të cilën ka kërkuar shtyrjen e afateve kontraktuale për zhvillimin e projektit;
 - b) afatin e pritshëm për përfundimin e testeve/komisionimit dhe vënien në punë të impiantit;
 - c) fillimin e punimeve për realizimin e projektit; dhe
 - ç) raportimet e depozituara pranë MIE-së, në zbatim të përcaktimeve kontraktore.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “BUSHTRICA 2017 ” sh.p.k., për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Paraqitja e ankimit nuk pezullon vlefshmërinë e vendimit, përveçse kur gjykata vendos ndryshe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI